

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shëndetësia falas një "mit"! Shqiptarët rekord për shpenzimet nga xhepi në Evropë - Shekulli
ADRESA	https://shekulli.com.al/2026/09/07/shendetesia-falas-nje-mit-shqiptaret-rekord-per-shpenzimet-nga-xhepi-ne-evrope/
BURIMI	shekulli.com.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 07:13:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 600 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 07:06:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dbc18590622f329d37e93fa3718e2ae25aabeebca71312aa89852aea19f67b3f2
TEKSTI	a633b945a86567f2a985219203a28d538afd67ed1e605dd08b7a15268b63788e
PAMJA	30551eb9f4f7e767166e83bb13b8b54bd037b57fd9fb0b38a3091304f64f494f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	40617c8f56c25c14ed457cf228d7911459886d1c384edcb1157a98a4cf159858
E MËPARSHMJA	e92269f6ea6b8469f5b5986fe9f7038d21fd1b25fd2f4960bd62827cc98440c8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/40617c8f56c25c14ed457cf228d7911459886d1c384edcb1157a98a4cf159858>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [HOME](#)
- [POLITIKË](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KRONIKË](#)
- [BOTA](#)
- [REAL ESTATE](#)
- [EMIGRANTËT](#)
- [SPORT](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [EXTRA](#)
- [OPINION](#)

Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri
“Shekulli Group”



Shëndetësia falas një “mit”! Shqiptarët rekord për shpenzimet nga xhepi në Evropë

Publikuar më **07.09.2026** nga **Shek**

Shqipëria vijon të mbetet shumë larg Bashkimit European për burimet që shkojnë në shëndetësi. Diferenca është e madhe jo vetëm në euro, por mbetet e thellë edhe pasi eliminohet efekti i çmimeve më të ulëta në vend.

Krahas nivelit shumë më të ulët të konsumit real për frymë, sistemi shqiptar karakterizohet edhe nga një barrë shumë më e madhe financiare që bie drejtpërdrejt mbi familjet, që detyrohen të financojë nga xhepi gati gjysmën e shpenzimeve shëndetësore, si rrjedhojë e shpenzimeve të ulëta të qeverisë.

Sipas të dhënave të Eurostat për vitin 2025, konsumi individual për shëndetësinë në Shqipëri llogaritet në 662 euro për banor, kundrejt 3,675 eurove mesatarisht në BE.



Në total, sipas Eurostat konsumi për shëndetësinë në Shqipëri në vitin 2025 ishte 1.56 miliardë euro. Kjo shumë përfaqëson 7.7% të konsumit individual aktual, ndërsa në BE shëndetësia zë 13.4%. Në rajon, kryesimin e mban Serbia, me 11.5%, ndërsa niveli më i ulët është në Maqedoninë e Veriut, me 5.8%. (shiko grafikun: Konsumi për shëndetësinë në raport me konsumin total individual, viti 2025)

Ky tregues nuk përfshin vetëm pagesat që qytetarët bëjnë drejtpërdrejt nga xhepi. Sipas metodologjisë së Eurostat, "Konsumi aktual individual" llogarit mallrat dhe shërbimet që konsumohen nga individët, pavarësisht nëse financohen nga vetë familjet, nga shteti apo nga institucione të tjera. Për këtë arsye, te shëndetësia përfshihen edhe shërbimet e financuara nga fondet publike.

Diferenca nominale me Europën ndikohet nga çmimet. Niveli i çmimeve të produkteve dhe shërbimeve shëndetësore në Shqipëri në 2025 ishte vetëm 44.6% e mesatares së BE-së. Si rrjedhojë, 662 euro në Shqipëri blejnë më shumë shërbime sesa e njëjta shumë në një vend mesatar të BE.

Megjithatë, edhe pas korrigjimit për diferencat e çmimeve, hendeku mbetet i thellë. I shprehur në standardin e fuqisë blerëse, konsumi për shëndetësinë arrin në rreth 1,500 PPS për banor në Shqipëri, kundrejt rreth 3,700 PPS në BE. Pra, volumi real i mallrave dhe shërbimeve shëndetësore të konsumuara për person në Shqipëri është vetëm rreth 40% e mesatares europiane.

Si rrjedhojë, diferenca nuk mund të shpjegohet vetëm me faktin që mjekët, analizat, barnat apo shërbimet e tjera kushtojnë më pak në Shqipëri. Edhe kur krahasimi bëhet me çmime të barazuara, shqiptarët kanë në dispozicion një volum dukshëm më të ulët shërbimesh dhe produktesh shëndetësore.

Edhe treguesit e përgjithshëm të financimit të sistemit japin të njëjtën tablo. Sipas bazës së të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të publikuara edhe nga Banka Botërore, shpenzimet korrente për shëndetësinë në Shqipëri ishin 7.05% e PBB-së në vitin 2023. Në Bashkimin Europian, në të njëjtin vit, ato arrihen në 10% të PBB-së.

Shqiptarët paguajnë shumë më tepër nga xhepi

Përveçse shpenzimet për shëndetin në tërësi janë të ulëta, problemi bëhet edhe më i dukshëm kur shihet mënyra si financohet kujdesi shëndetësor. Në Shqipëri, 48.27% e shpenzimeve korrente për shëndetësinë në 2023 u paguan drejtpërdrejt nga familjet, sipas të dhënave nga Banka Botërore. Praktikisht, pothuajse një në çdo dy euro të shpenzuara për shëndetin del drejtpërdrejt nga xhepi i qytetarëve.



Ky është niveli më i lartë në Europë. Në vend të dytë është Maqedonia e Veriut (39.6%) e ndjekur nga Bullgaria (35.5%). Në rajon, pagesat më të ulëta nga xhepi janë në Mal të Zi (26.3)- shiko grafikun Shpenzimet nga xhepi, ndaj totalit viti 2023.

Në BE, pagesat direkte të familjeve përbënin vetëm 14.9% të shpenzimeve shëndetësore.

Dallimi lidhet me rolin shumë më të madh që ka financimi kolektiv në vendet e BE-së. Në vitin 2023, 52.3% e shpenzimeve shëndetësore në BE financoheshin nga skemat e detyrueshme të sigurimit dhe 28.2% nga skemat qeveritare. Së bashku, këto burime mbulonin 80.6% të fatursë së shëndetësisë. Në Shqipëri, burimet publike vendase financin rreth 49.6% të shpenzimeve korente për shëndetësinë në 2023./ [Monitor](#)

Për t'u bërë pjesë e grupit të "Shekulli" mjafton të klikoni: [Join our FB Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet.

KOMUNITETI SHEKULLI ONLINE: <https://www.facebook.com/groups/1381242728701899/>

[“Vetëm 9% e bizneseve shqiptare e përdorin Inteligjencën artificiale”, Ibrahimaj: Produktiviteti i vendit sa 1/3 e mesatares së BE](#)

[“Vetëm 9% e bizneseve shqiptare e përdorin Inteligjencën artificiale”, Ibrahimaj: Produktiviteti i vendit sa 1/3 e mesatares së BE](#)

Publikuar më 08.09.2026
Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, ka ...

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, ka deklaruar se Shqipëria duhet të përshpejtojë përfshirjen e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në ekonomi, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe ngushtimin e hendekut me Bashkimin Europian. Teksa ishte e pranishme së bashku me kryeministrin Edi Rama në Forumin e Dytë të Inovacionit, Ibrahimaj u ndal te zhvillimi [...]

[Lexo më shumë](#)

[Shqipëria ndërton pa fund, por mbetet e treta në Europë për privimin e rëndë nga strehimi](#)

[Shqipëria ndërton pa fund, por mbetet e treta në Europë për privimin e rëndë nga strehimi](#)

Publikuar më 08.09.2026
Shqipëria është vendi ku ndërtimi zë peshën më të lartë në e...

Shqipëria është vendi ku ndërtimi zë peshën më të lartë në ekonomi në Europë, por bumi i apartamenteve nuk ka zgjidhur problemin e kushteve të banimit. Në vitin 2023, 12.7% e popullsisë jetonte në privim të rëndë nga strehimi, norma e tretë më e lartë mes vendeve europiane të përfshira në të dhënat e Eurostat, [...]

[Lexo më shumë](#)

[Tirana dhe qytetet bregdetare, të varura nga ndërtimi](#)

[Tirana dhe qytetet bregdetare, të varura nga ndërtimi](#)

Publikuar më 07.09.2026
Kavaja, Himara, Vlora, Kamza, Durrësi, Vora janë bashkitë më...

Kavaja, Himara, Vlora, Kamza, Durrësi, Vora janë bashkitë më të varura nga të ardhurat që gjeneron ndërtimi, pasi të paktën 40% e të ardhurave të tyre të veta vijnë nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) sipas të dhënave që i takojnë 2025. Edhe Tirana e ka këtë tregues afër 40%. Varësia është veçanërisht e [...]

[Lexo më shumë](#)

[ERE “zbut Tigrat” e Vlorës, pezullon licencën e TEC-eve deri në sqarimin e lejes mjedisore](#)

[ERE “zbut Tigrat” e Vlorës, pezullon licencën e TEC-eve deri në sqarimin e lejes mjedisore](#)

Publikuar më 07.09.2026
Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka pezulluar procedurën e...

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka pezulluar procedurën e licencimit për prodhimin e energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3” në Vlorë. Në vendimin e datës 3 shtator, ERE përcakton se pezullimi do të vijojë deri në sqarimin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) të vlefshmërisë së lejeve mjedisore për operimin e [...]

[Lexo më shumë](#)

[Tender pas tenderi, Unaza e shembur e Burrelit gëlltit mbi 2 milionë euro](#)

[Tender pas tenderi, Unaza e shembur e Burrelit gëlltit mbi 2 milionë euro](#)

Publikuar më 07.09.2026
Pamjet nga Unaza e Poshme e Burrelit të japin përshtypjen e...

Pamjet nga Unaza e Poshme e Burrelit të japin përshtypjen e një ngrehine të mbetur pas ndonjë ngjarjeje apokaliptike. Në njërin segment, asfalti është çarë duke lënë të zbuluara shtresat e zhavorrit dhe betonit mbajtës, ndërsa mbi pjesën e shembur pranë një pusete janë vendosur disa gurë si sinjalistikë, për të paralajmëruar këdo që rastësisht [...]

[Lexo më shumë](#)

[Ndërtimet dhe kaosi “largojnë” turistët nga bregdeti! Ja çfarë po i tërheq vizitorët drejt vendit tonë](#)

[Ndërtimet dhe kaosi “largojnë” turistët nga bregdeti! Ja çfarë po i tërheq vizitorët drejt vendit tonë](#)

Publikuar më 06.09.2026
Nëse Shqipëria do ta gjykonte sezonin turistik vetëm nga fotografitë në Instagram, vera e vitit 2026 do të dukej thuajse e përsosur. Ujë i kaltër në Ksamil, kroçiere përpara Sarandës, tavolina buzë detit

Nëse Shqipëria do ta gjykonte sezonin turistik vetëm nga fotografitë në Instagram, vera e vitit 2026 do të dukej thuajse e përsosur. Ujë i kaltër në Ksamil, kroçiere përpara Sarandës, tavolina buzë detit në Himarë dhe një lumë makinash që zbriste çdo fundjavë drejt Jugut. Por turistët e sotëm kanë një zakon: pasi bëjnë foton [...]

[Lexo më shumë](#)

[Rregulla të reja për tarifën e këmbimit valutor në ATM dhe dyqane](#)

[Rregulla të reja për tarifën e këmbimit valutor në ATM dhe dyqane](#)

Publikuar më 05.09.2026
Për të përdorur kartën e bankës me qëllim tërheqjen e parave...

Për të përdorur kartën e bankës me qëllim tërheqjen e parave në ATM ose për të bërë blerje në dyqane përmes POS-eve, shpesh qytetarët përballen edhe me tarifa shtesë për këmbimin e monedhës, të cilat i vënë re vetëm pasi u janë hequr nga llogaria. Por duket se këtij problemi i ka ardhur fundi. Banka [...]

[Lexo më shumë](#)

[ANALIZA- A rrezikojmë rritjen e çmimeve kur të hymë në BE?!](#)

[ANALIZA- A rrezikojmë rritjen e çmimeve kur të hymë në BE?!](#)

Publikuar më 05.09.2026
Shqipëria hyn në fazën përfundimtare të procesit të anëtarës...

Shqipëria hyn në fazën përfundimtare të procesit të anëtarësimit në BE nga një pozicion i fortë stabiliteti makroekonomik. Rritja ekonomike është ndër më të lartat në Europë, inflacioni mbetet i kontrolluar, borxhi publik është ulur dhe bilanci i jashtëm janë përmirësuar. Megjithatë këto kushte mbështesin anëtarësimin, konvergjenca afatgjatë me BE-në do të varet më shumë [...]

[Lexo më shumë](#)

Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri

Redaksia:

[\[email protected\]](#)

Marketing:

[\[email protected\]](#)

[Politikat e privatesisë](#)

“Shekulli Group”

SHEKULLI © 2023 Web Maintained by [evolve.al](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.